

BIBLIOTEKA

908

SH.12

HALIL SHABANI

*Trashëgimia  
kulturore  
e Konispolit*

908  
3H12

*Halil Shabani*

*Trashëgimia  
kulturore e  
Kenispolit*

56977



**BOTIMET "MILOSAO"**

## PARATHËNIE

Kultura shqiptare në të gjithë përbërësit e saj, lulëzoi në shekuj. Ajo në shumë drejtime të saj arriti nivele të larta duke ruajtur traditën kombëtare në përshtatje me zhvillimet e kohës, duke krijuar vlera dhe tipare të qënësishme.

Nga të gjitha strukturat, më themelorja dhe më e qëndrueshmja është trashgimia kulturore shqiptare. Qëllimi kryesor në këtë aspekt është ruajtja e origjinalitetit të kulturës sonë. Kjo na shërben në radhë të parë për forcimin e indentitetit tonë kombëar dhe së dyti tregon vendin që zenë në rrjedhën e historisë së Evropës e më gjerë.

Në kohën që po jetojmë trashëgimia kulturore merr rëndësi teje të veçanta si gjeneratore e fuqishme në zhvillimin e përgjithshëm shoqëror, tregon epërsinë e mendimit dhe qëndrimit qytetar, për kulturën në përgjithësi dhe prosperitetit kombëtar në veçanti.

Është faktë që vitet e fundit trashgimia jonë kulturore u dëmtua duke prishur objekte të çmuara, duke grabitur nga pavionet e muzeumeve tona objekte me vlera të pa llogaritshme. Ajo që bie në sy është zhdukja e objekteve që i takojnë autoktonisë së kulturës sonë, ndaj ruajtja e objekteve të kulturës është kaq e rëndësishme.

Objekte të trashgimisë kulturore, si në të gjithë Shqipërinë, ka edhe në qytezën e Konispolit. Ky vendbanim ruan në gjirin e vet shtresa të

shumta kulturash e qytetrimesh. Përmëdim këtu shpellën e Kërshmoit, qytezën antike të Ajtoit, vendbanimet, Stismas, Lumbardhë etj, të cilat e rrethojnë qytezën e Konispolit në një rreze deri 4 km.

Në shekullin 17-18 në Konispol vihet re një përhapje e kulturës islame sidomos në objektet e kultit. Ndërtimi dhe arkitektura e tyre ka karakteristika të veçanta.

Banesa karakteristike e Konispolit është dy katshe me orientim sipas terrenit dhe me konstruksion guri. Në fund të shekullit të XIX vihen re ndërtime me masive, ndërtesa karakteristike këto të qyteteve të jugut. Qemeri me dyer dhe dritare dhe qoshet e gdhëndura janë dy elemente arkitekturore që i gjenë pothuajse në të gjitha ndërtimet. Vlen të përmëndet ndërtimi i portave të medha të oboreve me harqe e qemere dhe me gurë të gdhëndur bukur, traditë kjo që nga qyteti antik i Ajtoit (porta e madhe e ekspozuar në Muzeun Historik Kombëtar). Sot në Konispol numërohen mbi 20 porta të tilla të ruajtura mirë.

Konispoli ka patur lidhje ekonomike dhe tregëtare me Delvinën dhe Filatin por edhe me qytete të Greqisë si Korfuzi. Ata kanë bashkëjetuar duke ruajtur secili individualitetin dhe traditën e vet.

Duke përshëndetur iniciativën e Z. Halil Shabani për të pasqyruar trashgiminë kulturore të qytezës së Konispolit, mendoj se punimi i tij është i vlefshëm dhe i shërben përpjekjeve të gjithanshme për ta përfshirë edhe këtë trevë në lëvizjen mbarëkombëtare drejt Europës në shekullin e ri.

Safet Ademi

Konispol, janar 2000

Konispoli shtrihet në skajin më jugor të Shqipërisë, 40 km në jugë lindje të qytetit të Sarandës. Ai është ndërtuar mbi një pllajë 250-300 metra mbi nivelin e detit. Rrethuar nga mali i Saraqinit jo shumë i lartë (1036m) edhe kodrat e Nartës (700 m), të zhveshura nga bimësia e lartë

Bimësia e ulët e shkureve është e zhvilluar në të gjithë sipërfaqen, ndërsa në perëndim të qytetit të Konispolit ndodhet një pyll i dendur me pisha të buta. Përmendet dhe dallohet si vend kurativ me dimër të butë dhe verë të freskët. Freskinë kësaj klime me plot shendet për banorët, ia jep afërsia me detin Jon me rreth 2 km larg në vijë ajrore. Lugina e




Vardharit në perëndim të Konospolit, krijon një mikroklimë të nxehtë ku lulëzojnë bajamet, dardhat, fiqtë, ullinjë, lulet shumëngjyrëshe dhe sherebeli me hamocfakën. Në të gjitha oboret e shtëpive harlisen hardhitë të rrethuara nga bajamet e ullinjë.

Nga perëndimi dhe veriu, Konispoli krijon pamje tepër piktoreske me hapsira me detin Jon, Çukën e Ajotit në formë konike e deri në ishullin turistik të Korfuzit, fushën e blertë të Vrinës, Mursisë dhe deri në gjirin e Sarandës.

Rreth Konispolit ka lëndina dhe vënde të përshtatshme për eskursion dhe për ushtrimin e sporteve.

Pamje mahnitëse merr Konispoli në perëndim të diellit, në çastin kur dielli eret largë në detin Jonë mes ngjyrës së kuqeremtë e të ndritshme.



Pamje e Konispolit

Ai qëndron vezullues mbi ballkonin e tij natyror mbi kodrat e Buarit e

bregut të Koçit. Ka banesa monumente kulture me arkitekture të zhvilluar të grupuara që formojnë ansamble ndërtimi por edhe të veçuara.

26.000 vjet më parë është shekulli dhe viti ku zë fill jeta në Konispol. Shpella e Kreshmoit e Konispolit, që gjendet rreth 1km në vijën ajrore në veri të qytetit shënon këtë datë, kur ka zënë fill jeta e njeriut të komunës primitive. Këtë e dëshmojnë veglat e punës prej stralli, enët prej balte, veglat e punës prej kocke si dhe gjetja e një kokre fare te elbit të egër në gjëndje të karbonizuar. Jeta në këtë shpellë vazhdoi shumë gjatë, gati në nëntë etapa historike rrjesht që arrijnë deri në mesjetën e mesme, në shekullin e XIII pas Krishtit. E parë në këtë këndvështrim ajo përbën nje rast unikal për gjithë trevat e Shqipërisë.



Kultura autoktone më e herëshme nga shpella e Kreshmoit, e krijuar nga

banorët vendas është ajo e punimit të strallit me tehe të retushuara si edhe shpueset që ndeshen më rrallë. Këto prodhime njihen qysh nga paleoliti i lartë dhe mezoliti në Ballkanin jugor.

Kultura e qeramikës përbën gjetjen më tipike në këtë vendbanim me jetë intensive. Në këtë kulturë spikatin kupat me buzë të drejta, enët prej balte me vegje tunelore dhe me fund të sheshtë.

Ornamentet ose zbukurimet e enëve janë impreso (pickim thoi) dhe të bëra me një instrument të ngjashëm me kulturën devollite. Njëkohësisht përfaqësohet edhe prodhimi vendas i pikturuar me grupe vijash paralele dhe motive tel me gjemba. Prodhimet e kulturës së bronzit, bakrit dhe hekurit përmenden për origjinalitetin e tyre, zbukuruar me dekoracion plastik dhe ıçizim.

Në periudhën protourbane banorët e kësaj shpelle populluan qytetin antik të Çukës së Ajtoit aty pranë (reth 2.5 km vijë ajrore). Në fund të shekullit V e fillim të shekullit IV para Krishtit këta banorë përveç mureve rrethuese të qytetit ndërtuan dhe vepra madhore të kulturës kombëtare shqiptare si Porta me qemer, godina e "pallatit" të qytetit antik të Çukës së Ajtoit, banesa të mbështetura në shkëmbinj, etj.


Porta me qemer përbën një rast unikal që shquhet ndër të gjitha ndërtimet në trevën e Epirit dhe të Ilirisë. Në këtë mënyrë ajo përbën një ndërtim pikant me vlera të larta arkitektonike (sot ajo është e ekspozuar në një nga ambientet e Muzeut Kombëtar në Tiranë).

Jeta në Konispol më vonë vazhdoi në vendbanimin e hapur fshatar në bregun e Strerrës (Stizmazi) në banesat në Vardhar e Lumbardhë etj.

Ndër to më interesante dhe më i rëndësishmi është vendbanimi në bregun e Strerrës ose siç e quan populli "fshati në qafën e Stismave". Ky vendbanim përbëhet nga 20 banesa të ndërtuara në dy taraca, një burim uji dhe disa mure taracimi.

Deri sot të 20 banesat ruhen në gjëndje të mirë (deri në 1 m lartësi) ku në to pasqyrohen dy tipe arkitektonike. Ky vendbanim datohet i antikitetit të vonë e pikërisht në shekujt V-IX pas Krishtit.





*Porta me qemer e Çukës së Ajtait*



### *Vendbanimi në bregun e Sterrës*

Tipi i parë arkitektonik i banesave është me planimetri katërkëndëshe me dy ambiente të shkallëzuara, ku në ambjantin më të lartë është e zhvilluar një shkallëzim ose sofat prej guri .

Tipi i dytë arkitektonik i banesave është me planimetri të harkuara në dy qoshet e banesave (zakonisht në qoshet e përparme) dhe përbëhet vetëm nga dy mjedise ku mungon elementi i shkallëzimit ose sofati.

Mendimi mbizotrues për Konispolin, në teritorin që shtrihet sot në 7 lagje është që në shekujt XII-XIII duke marrë për bazë gërmimet arkeologjike në Vardhar, Llotrua etj. Ndërsa dokumenti i parë i shkruar për Konispolin është ai 1431-1432. Ndërmarrja e regjistrimit të parë të popullsisë shqiptare që organizoi Perandoria Turke nëpërmjet feudalëve Osmanë në 1431-1432 përfshin edhe Konispolin. Nga Surreti defter Sancak arvonid 1431-1432 jepet Konispoli si "fshat me një skelë (Skela e Shën Todhrit, shënimi i H. Shabanit) me 1200 açe, bive (gra të veja) 2, Have 21, beqarë 3 dhe të ardhura të përgjithshme me shumën prej 2667

akçe”.


Duke u mbështetur në të dhëna të më vonshme dokumentare rezulton se me krijimin e pashallëkut të Janinës agallarët e Konispolit kërkonin pavarësi dhe për një periudhë të gjatë kohe nuk iu bindën Ali Pashë Tepelenës. Perkundrazi u lidhën me Suliotët dhe Ibrahim Pashën e Beratit, për të mos lejuar nënshtrimin e Çamërisë. Ndër këta agallarë shqueshin ata të derës së Dajlansve të Konispolit.

Popullsia e Konispolit përfaqsohej nga zejtarë, tregtarë, argatë dhe agallarë të mëdhenjë e të mesëm. Në kuptimin etnik popullsia përbëhej vetëm nga shqiptarë të besimit musliman e të konvertuar si të tillë në shekujt XVII-XVIII e në vazhdim. Besimi i mëparshëm ka qenë i krishterë. Në dobi të kësaj teze flasin emërtimet si Prroi i Pirros, Bregu i Koçit, etj. Konispoli së bashku me rrethinat ose fshatrat rreth tij në periudhën e sundimit Turk e më vonë përbëhet nga një popullsi e pastër islamike, gjë që spjegohet nga faktorët ekonomikë e ushtarakë që favorizuan bejlerët e Konispolit, të cilët zotëronin territorin deri në ksamil, por edhe me faktorët psikologjikë për të mos patur të njëjtën fe me fqinjët grekë.


Nga pikpamja urbanistike ai pasqyrohet nëpër gravura të shekullit XX. Për ndërtimin e tij tregojnë edhe rrënojat e sotme dhe relievi, kalatë e vjetra dhe banesat me arkitekturë të zhvilluar.

Qyteti i dikurshëm i Konispolit ka qenë i ndërtuar dhe i ngritur mbi pesë kodra në rrëzë të faqes së malit të Saraqinit. Këto pesë kodra së bashku me lagjen e bregut të Koçit që rri mbi të, ngjajnë me një dorë të fuqishme ku në çdo gisht është ndërtuar një lagje. Qendra e qytetit ishte e ngritur në një kodër në formën e një tarace me lartësi rreth 250 m mbi nivelin e detit. Qysh në mesjetë në shekullin XII këtu është ngritur “pazari”, vendi ku bëhej tregu dhe qysh atëhere është trashëguar emri pazar. Pazarit përbëhej nga një rrugë e gjerë e kalldrëmtë, ku nga të dya anët qenë ngritur dyqanet, zejtarët e qytetit, hekurpunuesit, samarpunuesit, argjendarët, librarët etj.


Ndërtimet e godinave të para të pazarit të Konispolit janë ato të fundit të shekullit XVIII. Pazarit mori formë të plotë në fillim të shekullit XIX.



Pamje nga pazari i Konispolit, gjysma e parë e shek.XX



Pamje e pjesës jugore të pazarit të Konispolit (foto e vitit 1950)



Një godinë dy katëshe që përdorej si nënprefekturë dhe si karabinieri  
(foto e v. 1950)

Lidhjet midis lagjeve të qytetit bëheshin nëpërmjet rrugëve të këmbësorëve dhe në lagjet me terren më të butë, lidhjet bëheshin nëpërmjet rrugëve të gjera që kalonin karrocet. Kultura në Konispol u zhvillua nën ndikimin islamik-turk. Por afërsia me Korfuzin, Sajadhën e Filatin si qendra të zhvilluara tregtare, ndikuan edhe për elemente të iluminizmit evropian. Sidomos tregtarët dhe agallarët e Konispolit jo vetëm kishin lidhje tregtare me Korfuzin por frekuentonin tepër qëndrat e zhvilluara kulturore korfjate që sollën elemente të tyre në Konispol. Shekulli XIX ishte periudha kur Konispoli njohu zhvillimin më të madh urbanistik, tregtar, fetar dhe numrin më të madh të popullsisë.

Pronarët kryesor të dyqaneve në pazarin e Konispolit kanë qenë: Në radhën e poshtme të rrugës qenë pronë e Izet Dautit, ndërsa radha e sipërme qenë prona të familjeve të pasura të Harjullenjve, Muderizenjve, Plakajve etj. Pronarë të klubeve, hoteleve dhe restoranteve qenë edhe Ismail Dalani dhe Nuri Besho nga Markati.


Pazari I Konispolit ka qenë një pazar tipik i qyteteve mesjetare të vendit tonë. Ai ka analogji me pazarin e vjetër të Filatit dhe atë të Delvinës. Rruga e Kalldrëmeve në qëndër dhe dy anët me radhë e dyqaneve ishte jo vetëm funksionale por edhe nje ansambël arkitektonik ku dominonin hyrjet dhe dritaret me harqe si dhe banesat dy katshe të lidhura varg njëra pas tjetrës. Komplekset e dyqaneve, shëbimet, kafenetë, restorantet si dhe fjetoret ose hotelet plotësonin të gjitha kërkesat e vizitorëve që vinin në Konispol. Në 1967 nga sistemi diktatorial u prish pazari i Konispolit në kuadrin e zgjerimit të sheshit ku gjendej ai. Sot kanë ngelur reliket e pazarit të vjetër të Konispolit, vetëm nga disa dyqane të pjesës së poshtme .

## ARKITEKTURA

Numri më i madh i banesave të Konispolit mendohet të kenë qenë dy katëshe. Këtë e vërejmë jo vetëm nëpër gravurat e shekullit XVII-XIX por edhe në fotografitë e fillimit të shekullit XX. Edhe autorë të ndryshëm që kanë vizituar në shekuj Konispolin kanë aritur në këtë përfundim. Konsulli Francez në Janinë Pukëvili si dhe konsulli angles Martin Liku në përshkrimet e tyre që kanë dhënë për Konispolin dhe për banesat e Konispolit i përshkruajnë “si banesa të gurta me dy kate”. Ndërsa në mesjetë e në veçanti që nga çereku i parë i shekullit XIX e deri në fillim të shekullit XX në Konispol është trashëguar një tipologji dhe arkitekturë e banesës së vjetër tradicionale dy kateshe. Kushtet ekonomike shoqërore, terreni, materialet e ndërtimit dhe mjeshtrit popullorë, kanë qenë faktorët kryesorë që kanë përcaktuar kompozimin planimetrik e volumor si dhe formulimin arkitektonik të banesës. Përveç banesave të veçanta në Konispol ruhen edhe ansamble me vlerë të madhe arkitektonike. I tillë është ansambli arkitektonik në lagjen e Buarit ose të Shehatit.


Ndër tipet kryesore të banesave me arkitekturë të zhvilluar janë ato të tipeve banesa qytetare me zhvillim me një krah, banesa me zhvillim me dy krahë ose “divitë”, banesa me zhvillime në dy krahët dhe me kullën mbrojtëse etj. Gjithashtu në Konispol arkitektura e banesës përfaqësohet edhe me banesën e tipit kullë në tre raste. Dy rastet janë në lagjen Buar e Pazar të familjeve të mëdha të Dajlansve e Takajve, si dhe rasti i tretë në lagjen Llanxat. E veçanta e këtij është shtëpia Kullë e Veip Mushit.





Ansambli arkitektonik i banesave mesjetare në lagjen Shehat të  
Konispolit


56P77




Banesa qytetare e Shaban Goxhait me zhvillim në dy krahë,  
me portën në një krah te oborit



Banesa qytetare e Shefqet Haxhiut me zhvillim në dy krahë, me  
portën në një krah të oborit.



Banesa tip kullë e Takajve




Banesa tip kullë e Mahmut Dalanit



Banesa me pseudo çardak në oborin e shtëpisë së Shefqet Haxhiut


Sigurisht që banesat me arkitekturë të zhvilluar me dy kate e deri në ato qytetare me zhvillim në një dhe dy krah (divitë) banesa me pseudo çardak, portat e oborit me qemer, qoshet e harkuara bukur etj që të gjitha janë ndërtuar me gurë të cilësisë së mirë që gjenden në çdo territor të Konispolit. Formulimi arkitektonik dhe kompozicioni planimetrik që në Konispol mer vlera deri në ansamble ose grupe banesash të tilla siç është rasti në lagjen Shehat janë vepra të klasave të shtresave të pasura të Konispolit.

Por kjo nuk do të thotë se në banesat e tjera të masave të thjeshta të popullsisë nuk ndiqej ndonjë planimetri ose arkitekturë qoftë dhe më e thjeshtë. Ne kemi mundur të eidentojmë banesa të shtresave të ulta të popullsisë që janë ndërtuar nga fundi i shekullit XIX. Edhe këto banesa janë ndërtuar me material guri dhe se në Konispol në asnjë periudhë banesat, sado të varfëra të ishin klasat, nuk janë ndërtuar asnjëherë me kashtë ose kasolle siç ka ndodhur në krahinat e Vurgut apo të Mursisë, fqinjë të tyre. Këto banesa të fundit të shekullit XIX pëbëhen shpesh nga




Kulla mbrojtëse pas banesës qytetare në lagjen Buar


dy kate por në dallim nga ato qytetare, në katin e parë strehoheshin kafshët dhe se quhej katua. Në katin e dytë banonin familjet. Edhe në këto banesa qemeri dhe harqet janë reflektuar tek porta e katoit, dritaret dhe dera e shtëpisë. Si material për mbulimin e këtyre banesave të thjeshta gjithmonë janë përdorur rrasa të holla guri që nxirreshin në malin e Saraqinit.



Banesë tipike e shtresave të pasura



Banesa me zhvillim në dy krah e Alush Takës



Banesë e thjeshtë në Konispol, fundi i shek.XIX



Banesë e thjeshtë në lagjen e Lirzatis shek. XIX



Banesë e thjeshtë, fundi i shek. XIX



## ARTI

Vendin e parë e zënë objektet e kultit, që nisin në fillimet e shekullit XVII. Piktura ka lënë pak gjurmë nga themelet e këtij qyteti. Thërrime nga pikturat e shekullit XVII e XVIII i gjejmë vetëm në mbeturinat e xhamive të lagjeve, por ato janë tepër të dëmtura.

Monumentet e kultit të këtij qyteti mesjetar kanë një vlerë të madhe për artin tonë të shekujve XVII-XX. Nga veprat e bukura të pikturës murale kanë ngelur tepër të dëmtuara. Gjithashtu kanë zënë vend me vlerë edhe punimet e gdhëndura me dru. Mjeshtrit vendas apo të huaj i kanë kushtuar më tepër vëmendje gdhëndjes së tavaneve, formave të pasqyruar në mesin e tavanit, fushës rethuese si dhe qoshtet e tavanit. Edhe pjesës së dytë të ambjenteve të xhamise e sidomos ambjentit më të ngritur ku faleshin, gratë, mafilit që kryesisht ndërtohej prej druri të gdhëndur e i kushtohej një teknikë e lartë egzekutive me vizatime të holla dhe kolorit të pasur. Në këto ndërtime vërehet vazhdimi i traditës si dhe elemente të kulturës së Orientit. Këto elemente më tepër kanë spikatur në Medresenë e Konispolit dhe në pesë xhamitë.

Ndërsa në kompleksin ose ansamblin e ndërtesave të "koshadheve" në tyrbet ose teqetë pranë tyre në Llotrua, punimi artistik pasqyrohet më tepër në punimin e gurit. Ndër më pikantet qenë harqet e banesave, format e tyrebeve me tetë qoshe apo shumëkëndëshet të kombinuara me harqet.



Shtatore gruaje në terrakotë e gjetur në shpellën e Kërshmoit

Shikuar në këtë këndvështrim këto godina kulti të Konispolit kanë analogji me ato të Rusanit e Beqirefendit në Delvinë si dhe objekteve të kultit ndërtuar në fshatrat e Çamërisë si në Filat, Shalës, Ninat, Janjar e Markat.

Të gjitha këto objekte datohen brënda periudhës së sundimit Turk, kryesisht të shekujve XVII-XX.

## PORTAT ME QEMER

Kësaj arkitekture të zhvilluar të banesave i përgjigjeshin më së miri porta e madhe dhe obori i tyre. Të gjitha banesat që përshkruam më lart me arkitekturë të zhvilluar kishin dy ose tre porta, por ajo përballë fasadës së tyre ishte porta kryesore. Zakonisht këto porta të imponohen me përmasat e tyre që arrijnë deri në tre metra gjerësi dhe po aq lartësi. Janë të ndërtuara me blloqe prej guri të latuar me kujdes dhe mbështeten në të dy krahët nga muri rrethues i banesës ose avllia. Të gjitha portat janë ndërtuar me harkore me qemer prej guri, të lidhura me llaç të bollshëm. Shpesh mbi qemerin kryesor kalon edhe një rradhë blloqesh prej guri që formon pseudoqemerin.



Dy porta me qemer të banesës së Alush Takës (Buar)



*Dy portat me qemer të banesës së Dinomerajve (Buar)*

Streha e portave del edhe nga ana e brëndëshme e saj edhe nga ana e jashtëme mbuluar me tjegulla ose rrasa guri. Por midis tyre kishte edhe tipe portash me qemer ku sipër tyre ndërtohej një shesh pushimi që shpesh quhet dama. Të tilla porta janë ato të Dinomerajve, e Shaban Goxhait dhe e Shefqet Haxhiut.



*Një nga portat me arkitekturë më të zhvilluar e Dinomerajve*

Me siguri që në Konispol ka patur mbi 30 porta të tilla,por deri në ditët tona këto që u përmendën me lartë kanë arritur në gjendje të mirë ose janë restauruar.



*Një nga portat me arkitekturë të zhvilluar dhe me kube para qemerit  
(Buar)*

## MEDRESEJA E KONISPOLIT (shekulli XVI)

Që nga viti 1600 deri në 1910 në Konispol funksiononte Medreseja si pjesë e institucionit fetar islamik. Ajo është ndërtuar në një kurriz kodre në lagjen në një vënd dominant. Medreseja e Konispolit, sot është e vetmja godinë kulti që është ruajtur e pa dëmtuar, në këmbë. Përbëhet nga tre ambiente ku vendin kryesor e zë dhoma e mesit, mafili dhe ambienti i faljes së grave. Të tre ambientet përfshihen nga një kurbature e gjerë e plotë dritë që jepen nga dritare të vogla por që zenë vend në dy radhë në faqet e mureve ansore të objektit të kultit.




Foto 29 Pamje e përgjithshme e Medresesë

Vëllimin më të madh ndër tre ambientet e zë dhoma e mesit ose e faljes, që gjendet në jugëperëndim të objektit. Në pamjen ballore të tij gjendet qursi në formën e një harku thelluar në mur. Në pjesën e sipërme të harkut është i zbukuruar në mur me rombe të vegjël , lyer me ngjyrë të bardhë e rozë.

Në suvatimet e faqeve ansore të mureve deri sot nuk ka ngelur asnjë pikturë, pasi janë dëmtuar nga kohët dhe lyerja e vazhdueshme me gëlqere. Vlen të përmendet punimi me dru i tavaneve, ku fusha e tij është punuar me formë gjeometrike të rombeve, mesi i rrumbullakët ku brënda shkruhet.

Ndërsa në të katërt qoshet janë punuar në dru figura e shqiponjës. Në mes të gjatësisë së këtij ambienti janë vendosur tre shtylla druri në formë katërkëndëshe dhe në tavan ato janë zbuluar në harqe të gdhëndura në dru.



Pamje e brëndëshme e Medresesë



Deri sot mafili është dëmtuar, por ambienti që zinte ai është në vëllimin që i takon në vazhdim të ambientit të parë.

Mafili ka qënë ruajtur deri në 1975 dhe përbëhej tërësisht prej druri, i zbukuruar me shkallore, kangjella dhe taracim prej druri të gdhëndur. Ndërsa ambienti i tretë ndodhet në hyrje të medresesë. Është i shtruar prej rrasash guri.

Rruga e kalimit në qëndër me gjerësi rreth 1.5 m vjen e thelluar ndërsa nga të dy krahët ambienti lartësohet rreth 60 cm dhe shtrohet nga rrasat e gurit. Ky ambient shërbente për shërbime të ndryshme. Rreth 5 m në lindje të hyrjes së Medresesë është ndërtuar streha e ujit dhe më tej duken rrënojat e banesës ose fjetores së besimtarëve ose nxënësve.



Pamja e ambientit në hyrje të Medresesë (tavani)

Që nga viti 1700 deri 1910 ,në këtë medrese, si i vetmi institucion fetar islamik mësohej alfabeti arab. Ajo quhej ndryshe edhe shkollë fetare. Çdo vit arsimor në këtë medrese mësonin 70-80 djem ose nxënës nga trevat që shtriheshin që nga Tepelena në veri e deri në Janinë në lindje. Shkolla e plotë fetare vazhdonte katër vjet me këta nxënës dhe ata dilnin muhezinë ose imamë. Objektivi kryesor i kësaj medreseje ishte: të mësonin kuranin, të merrnin kulturë fetare islamike dhe të shërbenin mirë në xhamitë e fshatrave që do të emëroheshin nga Instiucioni Fetar i Shqipërisë. Nga puna që bënin në xhamitë e fshatrave, këta muhezinë ose imamë shndroheshin në hoxhë të fshatit. Ushqimi i nxënësve përballohej nga Institucioni Fetar Shqiptar si dhe një pjesë nga qyteti i Konispolit.

## XHAMIA NE LLOTRUA (Shekulli XVIII)

Është ndërtuar në gjysmën e parë të shekullit të XVIII (1630) nga fondet e reparteve të ushtrisë Turke të vendosura në banesat e koshadheve. Është vendosur në kurrizin e një kodre në vendin e quajtur Llotrua, pranë banesave të "koshadheve". Xhamia e Llotroit përbëhej nga salla e madhe ku zakonisht qëndronin burrat. Kjo dhomë ishte plotë dritë që vinte nga dritaret e mëdha me harqe. Ambienti i dytë ishte mafili i ngritur rreth 2 m më lartë nga ambienti i sallës së madhe dhe i veshur me dërrasa prej druri të gdhëndura bukur. Zakonisht këto dërrasa lyeshin me ngjyrë jeshile dhe kafe të errët. Ky ambient ishte vendqëndrimi ose vendi ku faleshin gratë. Burrat faleshin tek salla e madhe, kurse gratë tek mafili veç e veç.

Në krye të sallës së madhe ishte një vend i vogël i ngritur ku rrinte hoxha dhe quhej qursi. Në krahë të majtë të qursit formohej një dhomë e errët dhe e mbyllur që quhej vendi i hilitiqatit. Aty brënda vendosej një person që kryente rolin e vëzhguesit për të tjerët.

Minareja e kësaj xhamie ka qenë e lartë rreth 11 m. Në 1967 ndër masat e mara nga sistemi diktatorial për shkatërrimin e institucioneve fetare shkatërrrohet edhe xhamia e Llotroit. Deri në ditët tona ka arritur një pikturë e saj. Në këtë xhami bënin shërbesat fetare besimtarët e lagjeve Llanxat e Aliagat.

Brënda xhamisë së Llotroit kishte me shumicë libra fetare, ku vendin kryesor e zinte kurani. Muret lyeshin me gëlqere të bardhë përherë. ndërsa në faqet e brendëshme të mureve vareshin hali e banda me objekte kulture të Turqisë e Arabisë. Kapaciteti i saj ishte për 100 besimtarë.

## XHAMIA E SHEHATIT

Është ndërtuar në qendrën e lagjes Shehat, në një kurriz kodre. Ka të njëjtën planimetri dhe madhësi me xhaminë e Llotroit. E veçanta e saj është se kishte një minare më të ulët se ajo e Llotroit prej 7 m lartësi. Nga besimtarët është braktisur me vendosjen e sistemit diktatorial pas viteve 1945.

Edhe kjo xhami është shkatëruar në vitin 1967. Deri në ditët tona kanë arritur mure të dëmtuara të saj. Këtu bënin shërbesat fetare besimtarët e lagjes së Shehatit. Kapaciteti i saj për besimtarët ishte i përafërt me atë të Llotroit. Sot ka ngelur një gravurë e xhamisë së Shehatit



Xhamia e Shehatit pikturë e viteve 1960

## XHAMIA E PASHANJET

Është ndërtuar në lagjen e poshtme pothuajse në qëndër të saj në një bregore të vogël. Sistemi i ndërtimit, madhësia dhe lartësia e minaresë prej 11 m kanë analogji me xhaminë e llotroit. Kjo xhami u braktis nga besimtarët pas viteve 1945 kur në Shqipëri u vendos sistemi diktatorial. Si objekt u shkatërroi në vitin 1967. Hoxha i fundit që kryente shërbesat fetare ka qenë Mehmet Alushi. Deri në ditët tona na ka ngjatur një gravurë e punuar nga piktori i Konispolit Urim Arapi (1966)




Foto 35 Xhamia e Pashanjët në Çuçat

## XHAMIA E QENDRËS

Njihet me këtë emër pasi ishte e ndërtuar në qendër të Konispolit ose në qafën e pazarit të Konispolit. Është xhamia që është prishur më herët nga të tjerat (1925) pasi Këshilli Fetar i Myftinisë së Konispolit ia dha Komunës së Qeverisë së Ahmet Zogut. Ajo qeveri në vendin e xhamisë ndërtoi godinën dy katëshe të nënprefekturës së Konispolit.

Xhamia ishte ndërtuar në një kurriz kodre (pika më e lartë e pazarit të Konispolit) si vënd i zgjedhur dhe dominant për qytetin. Sot nuk kanë ngelur mure apo dëshmi të tjera të këtij objekti të kultit.




Foto 36 Xhamia e Qendrës ose e Qafës së Pazarit

## XHAMIA NË MEDRESE

Është xhamia më re e ndërtuar në Konispol në vendin e medresesë së Konispolit në 1930. Kësaj xhamie nuk ju ndërtua minareja pasi nuk mjaftuan fondet e Këshillit Islamik. Për ndërtimin e saj u interesua myftiu Emin Muderizi, i cili bënte dhe shërbesat fetare në këtë xhami.



Xhamia e Medresesë



Rreth kësaj xhamie, pranë një qeparizi shekullor, ndodhet një varr i shenjtë që tradicionalishtë njerëzit e nderojnë kur kalojnë (në anë të rrugës) dhe e quajnë ulema ose evlia. Aty është varrsur një shenjtore islamike. Që nga viti 1900 në Konispol (në medrese e xhami) kanë shërbyer Emin Muderizi -muderiz i shkolluar jashtë, Haxhi Murati -muderriz dhe erudit fetar islamik si dhe shkrimtar e poet (shërben deri në 1943). Hafuz Selim Peqini ka qenë kryetar i Myftinisë së Konispolit në fillim të shekullit XX. Gjithashtu dhe Fuat Kipeka qenë muderriz në Medresenë e Konispolit. Të gjithë këta myftinj kanë dhënë mësim fetar në Medresenë e Konispolit dhe kishin mbaruar shkollat fetare jashtë Shqipërisë. Me vendosjen e regjimit të Zogut në medrese u vendos shkolla fillore me pesë klasë.

## TYRBET NË LLOTRUA

Janë ndërtuar nga regjimenti i ushtrisë Turke, i vendosur në godinat e "Koshadheve" më 1630. U ndërtuan gjithsej 4 tyrbe. Ishin vendosur pranë njëra-tjetrës, në perëndim të xhamisë të Llotroit. Qëllimi i ndërtimit të tyre ishte ai i varrosjes së personave të shenjtë fetarë dhe ushtarakë të lartë të regjimentit.

Arkitektura e ndërtimit të tyre është ajo e formës poligonale tetëkëndëshe, ku në çdo faqe janë ndërtuar hyrjet me harqe ose me gemer. Mbulesa e tyrbeve është e harkuar në formë kubeje ose kupole e ndërtuar me gurë me përdorim llaçi të tepërt.

Këto tyrbe tradicionalisht nuk janë ndërtime të krahinës por huazime, të cilat i kanë sjellë në Konispol regjimenti i ushtrisë Turke, pra janë dëshmi të ndërtimeve të Orientit.



## ETIMOLOGJIA E EMRIT TË KONISPOLIT

Deri tani ngrihen dy versione. Versioni i parë është ai i prejardhjes nga sllavishtja, ku aludohet në zërthimin e emrit polje-fushë dhe konkuaj dhe jepet emri fusha e kuajve- Konispol. (Sigurisht që dyndjet sllave këtu erdhën në shekullin VI-IX pas Krishtit). Ndërsa versioni i dytë është ai me origjinë greke, ku aludohet polis-qytet dhe kondisma-vend i shenjtë që, duke u bashkuar, na japin Konispol ose qytet i kondizimave. Por deri tani dokument arkivor në shekuj nuk kemi të konfirmuar, kështu që këto ngelen vetëm në kuadrin e versioneve.

## PUNIME TË TRASHËGUARA TË ARTIT TRADICIONAL

Pjesë përbërëse e punimeve të artit tradicional të trashëguar për Konispolin janë edhe terrakotat. Terrakotat ose skulpturat prej balte janë zbuluar në vitet 1989-1994 në gërmimet arkeologjike tek Shpella e Kreshmoit, fare pranë Konispolit.

Numri më i madh i terrakotave u gjet gjatë pastrimit të sipërfaqes së shpellës, të shpërndara në shtresat e sipërme të kuadrateve që i përkasin epokës së hekurit dhe asaj mesjetare. Mbështetur në tipologjinë e paraqitjes së tyre ato ndahen në tre grupe: në formë busti dhe shtatore, në formë skematike dhe në formë basorielievi. Në grupin e parë, atë në formë busti dhe shtatoreje renditen 14 copë. Ndër terrakotat e plota dhe më të bukura paraqitet koka e një femre, me tipare të rregullta, e kthyer pak nga ana e djathtë, me hundë të drejtë e mejkër të rrumbullakët. Me shikim të hedhur para, flokët e krehura bukur të ndara me vijë ne mes. Mbi flokë paraqitet një kordele që rrethon gjithë perimetrin e sipërm të kokës. Poshtë veshit të majtë është e zbukuruar nga një vëth.

Këto tipare nxjerrin në dukje bukurinë e femrës, që ne nuk e teprojmë ta pagëzojmë me emrin "Bukuroshja e Konispolit". Ajo paraqet analogji me një nga varietetet e Afërditës (perëndesha e bukurisë) zbuluar në liqenin e Stefananit në Elbasan nga arkeologu Neritran Ceka. Të ngjashme me kokën e Afërditës që përshkruam më lartë u gjetën edhe dy kokë të tjera por janë të dëmtuara. Ndër shtatoret e grave (ose të femrave) janë

gjetur 11 copë, por më të plota ruhen tre prej tyre. Shtatorja ose trupi i një femre me gjatësi më të madhe arriti në 21 cm, që i mungojnë koka dhe shputa e këmbëve. Tek kjo shtatore dallohen qartë të gjitha linjat e trupit si shpatulla, gjoksi, beli dhe këmbët. Interas paraqet veshja, e cila përbëhet nga një mëngë e gjatë. Rreth qafës duket se është hedhur një shami. Krahu i majtë është hedhur mbrapa trupit e duket sikur mban palët e fustanit. Në pjesën e mbrapme të trupit, tek beli, ka të prerë një kuadrat në formë katërkëndëshi 4X3 cm. Me siguri është prerë për t'u varur diku për ekspozim në faqe muri apo në ndonjë vend tjetër. Fustani i hapur në formë trekëndëshi dhe elementet e tjera të petkut, gjejnë analogji me shtatore ose buste të tjera të vendit tonë si gruaja e skalitur në një stelë të Apollonisë përshkruar nga Andromaqi Gjergji, Fingija në koleksionin e Vlorës përshkruar nga G.P Sestieri, Mina e zbuluar në Belesh të Elbasanit (bust i pabotuar, ruhet në Muzeun Arkeologjik të Tiranës, si dhe busti i një gruaje nga Ishmi i Durrësit, përshkruar nga Damjano Komata).

E veçanta e këtyre shtatoreve është se na japin elementet e veshjes së grave Konispoliate. Shtatoret e tjera janë të dëmtuara.

Në grupin e dytë të terrakoteve që paraqiten në formë skematike janë gjetur 19 copë. Në përgjithësi ato paraqesin trupin e njeriut në formë linjash, ku dallohen pjesët kryesore si koka, krahët e trupi në formë kryqi. Gjatësia e përgjithëshme e tyre luhatet nga 6.5 deri në 13.5 cm. Në përgjithësi forma e tyre është e njëjte dhe në disa raste dallohen pak në të kushtuarit e vëmendjes tek koka dhe sytë. Shumica e tyre janë të dëmtuara tek këmbët. Trupi i tyre paraqitet në shumicën e rasteve në formë pllake ose të shtypur dhe në pak raste në formë cilindrike. Paraqitja e këtij tipi ku dallohen edhe nëntipe, flet qartë se pasqyrimi në punimet prej balte të mjeshtrave vendas ishte plot fantazi dhe me një zgjidhje e pasqyrim sa më të lashtë aq edhe modern për artin e sotëm me plot variante linjash.

Tipi i tretë përfaqsohet nga katër basorelieve, paraqitur në nje punim prej balte të kuqerremtë.

Në basorelievin e parë që është më i spikatur paraqiten katër femra të

lidhura dorë prej dore duke hedhur valle.


Të katërta femrat janë të orientuara nga ana e djathtë, ku shputat e këmbëve paraqiten në lëvizje. Me interes paraqitet veshja e fëmrave prej fustaneve që zbresin deri tek këmbët dhe veshja e pjesës së sipërme të trupit. Por basorelievi është i thyer e i ndarë në dy pjesë dhe u gjet në dy kuadrate, por ato i përkasin të njëjtit basoreliev, sepse puthiten plotësisht. Tek veshja e femrës së parë, në krye të rreshtit, duket qartë veshja e dytë mbi fustan, që zbret deri tek gjuri, mundet që të jetë hematjani. Gjatësia e përgjithëshme e terroketës është 8.3 cm e gjerësia 4cm .

Në basorelievin e dytë paraqitet krahu i përthyer i njeriut që është i dëmtuar në pjesën e poshtëme. Në të duken qartë pesë gishtrinjtë e dorës së majtë.

Edhe në basorelievin e tretë paraqitet një fragment ku duken qartë forma e katër gishtrinjëve të dorës së djathtë dhe pak gishti i madh.

Në basorelievin e katërt paraqitet koka e një femre punuar mbi qeramikë ngjyrë rozë. Femra paraqitet me fytyrë të shëndoshë, me flokë të ndara në mes të kokës dhe disi spirale të hedhura anash. Rreth qafës është zbukuruar me një byzilik ku janë renditur zbukurime në formë trekëndëshi. Gjithashtu, në drejtim të gjoksit janë renditur zbukurime në formë harku e trekëndëshi. Me sa duket janë të parapëlqyer motivet në formë gjeometrike të trekëndëshit dhe të harqeve.

Si në basorelievet e më sipërme, në shtatoret e bustet paraqitet gruaja . Pra ,kulti i femrës, ku i atribohen asaj të gjitha variantet, bukuria femërore, zbukurimet si vëth, byziliqe etj, veshja jo e rënduar por e lehtë, është kulti më mbizotërues në Konispolin antik dhe atë mesjetar. Ornamente të tjera dekorative me motive të ndryshme ne i gjejmë tek enët e baltës si në pjatat, vorbat dhe skifoza. Këto punime artistike paraqiten me një sërë elementesh dekorativë si motive të trekëndëshave, valëzime vijash, tufë vijash paralele, motivi tel me gjëmba, spirale et. Interesant paraqiten terrakotat e varianteve të Afërditës ose të një perëndie vendase si dhe format kryq që përfaqësojnë figurinat e njerzëve ku spikat trupi i femrës




Punime antike në qeramikë me motive gjeometrike, etj. nga shpella e Kërshmoit



Disa variante të "Bukuroshes" së Konispolit, punuar në qeramikë(terrakota), Shpella e Kërshmoit





*Forma skematike e njeriut në terrakota të gjetura në shpellën  
e Kërshmoit*

Në trashigiminë e artit tradicional të Konispolit futen edhe punimet në gur. Në periudhën mesjetare këto punime përfaqësohen nga disa figura gjeometrike si trekëndësha apo themtha që viheshin në portat e gurta ose tek dyert kryesore të shtëpive, figura rombesh etj. Në qendër të qytetit, tek pazari mesjetar, kishte të ekspozuar edhe më tepër punime të gurta. Por në gjysmën e dytë të shekullit të XX në punimet e gurit një rol pikant ka lozur piktori dhe skulptori Urim Arapi. Duke qenë një talent i rrallë dhe autodidakt i heshtur ai ka punuar me dhjetra punime në gur. Midis të cilave mund të përmëdim: shatërvane uji, buste njerzish, kafshë e sidomos kuaj, zogj, rozeta, tavolina, porta prej guri, oxhaqe dhe kanape prej guri



Shatërvan prej guri, punuar nga Urim Arapi



Rozetë prej guri e Urim Arapit

Nga sa përshkruam më lart, në lidhje me shumëllojshmërinë e terrakotave, të tipeve e nëntipeve të tyre është dëshmia më e plotë për pasurinë e variacioneve të paraqitura në mënyrë artistike. Në qoftë se do të veçojmë kordelen mbi ballë të femrës, vëthin, flokët të ndara në mes e të krehura me gusto, veshjen e elegancën e hedhjes së valles, format e trupit të shnërvjellët, etj tregojnë për një plastikë të zhvilluar artistike në prodhimet vëndase te punimet prej balte. Njëkohësisht ato pasqyrojnë një trevë me elementë të zhvilluar të kulturës artistike deri tek perëndesha e bukurisë siç është Afërdita apo ndoshta një perëndi vëndase.

Tipat e paraqitjes në mënyrë skematike ka mundësi të jenë ndërtuar me dorë, ndërsa tipat e tjera, shtatoret, bustet dhe basorelievet me siguri janë ndërtuar me derdhje ose me kallëpe. Këto dëshmojnë se

banorët e periudhës antike e mesjetare të Konispolit njohin variantet e punimit të qeramikës dhe poçerinë si dhe artin e skulpturës.

Ka shumë mundësi, nisur edhe nga toponimi "Shpella e Kreshmoit" që në këtë vend të zhvilloheshin edhe ceremonitë fetare ose kreshmët.

Me siguri ky na pasqyron edhe vëndin tipik që mbart kalimin e dy kulturave, atë antike të besimit të krishterë (kreshmoi) si vëndi i shenjtë kulturi ku adhurroheshin shtatoret ose terrakotat apo figurinat prej balte e deri në periudhën mesjetare që vazhdoi jeta në këtë shpellë. Pas mesjetës kultura islamike u pasqyrua jashtë këtij vendbanimi, në territor të hapur të Konispolit, në vendet e tjera të kultit si xhami, medrese, tyrbet etj.

## KALATË E KONISPOLIT

Nër veprat e artit të aplikuar në shekuj në Konispol, hyjnë dhe ndërtimi i kalave. Pozicioni strategjik mbi nje pllajë e kodra të larta, hapësirat e mëdha nga veriu e perëndimi që kontrollojnë luginën e Vardharit e deri në ujrat e kaltra e të pastra të Jonit, kanë kushtëzuar edhe ndërtimin e disa kalave në Konispol. Deri në ditët tona kanë arritur gjurmë e themele të tre kalave.

Ato janë kalaja e Buarit, Qafës së Pazarit dhe kalaja e bregut të Koçit. Sot gjurmët më të plota i ruan kalaja e Buarit, në një pozicion shumë të përshtatshëm strategjik që kontrollon të gjitha pikat e horizontit. Deri në ditët tona nga kjo kala kanë arritur muret e anës jugore të saj, depozita e sterrës së ujit dhe trajta jo të plota muresh rrethuese si dhe mureve të ambienteve të brendëshme të saj. Në muret rrethuese dhe ambientet e brendëshme të saj janë ruajtur postat dhe dyer me qemer si përbërje të elementeve arkitektonike. Nga gjurmimi i themeleve rezulton se kalaja ka patur planimetri katërkëndëshe. Kalaja e Buarit është ndërtuar në 1780 nga i pari i fisit të Bejkatëve. Në 1960 kalaja u shkatërrua dhe në vënd të saj u ndërtuan varrezat e dëshmorëve.


Kalaja e Qafës së Pazarit ka qënë e ngritur në kodrën ovale në jugperëndim të të pazarit të Konispolit, mbi një pozicion mjaftë strategjik që qarkonte një sipërfaqe reth 300 m<sup>2</sup>. Deri pas çlirimit ruheshin muret rrethuese dhe disa ambiente të saj. Por në vitet 1950-1960 në kuadrin e "rregullimit të ambientit reth pazarit" u rrafshua gjithçka me dorë dhe me mjete të rënda. Edhe në kalanë e Bregut të Koçit përveç dy depozitave të

sterrave të ujit nuk ka ngelur asgjë tjetër deri në ditët tona.

Të tëra kalatë janë të periudhës mesjetare nga shekulli XVI-XIX

Përballë qytetit të Konispolit, në kurrizin e kodrës së Nartës gjendet edhe një kala tjetër mesjetare. Ajo veçohet nga tre kalatë e tjera sepse është e mbajtur me muret rrethuese të saj dhe me një sipërfaqe më të vogël se të tjerat. Por ajo që e dallon më tepër është se përbëhet nga tre mure rrethuese në anën veriore të saj.

Brenda teritorit të kalasë gjenden themelet e katër banesave dhe qeramikë mesjetare me shumicë. Pikërisht në mesin e saj në drejtimin lindje-perëndim kalon kufiri shtetëror shqiptaro-grek.



Pamje e murit jugor të kalasë së Buarit

## VEESHJA POPULLORE E KONISPOLIT

Pjesë përbërse e kulturës materiale e popullore të Konispolit janë edhe veshja popullore, zejet e mjeshtrit poullorë. Duke qenë njësi e veçantë gjeografike, demografike me kufinj të qartë e dallues, Konispoli në grupin etnik shqiptar në shekuj është dalluar edhe nga veshja popullore karakteristike edhe me tiparet e saj. Qysh në shekullin XVIII-XIX, në veçanti udhëtarët anglezë, kanë treguar interes të veçantë për kulturën popullore të Konispolit e sidomos për veshjen konispolate. Këta udhëtarë e studiues anglezë, kulturën materiale e shpirtërore e morën si komponent të rëndësishëm etnik të kombësisë shqiptare e cila po kalonte në këtë kohë procesin e formimit të saj si komb.

Liku, konsulli anglez në oborrin e Ali Pashë Tepelenës jep përshkrime të shumta për Konispolin e fshatrat rreth tij, udhëtarit tjetër anglez Hobhauzi, përshkruan shtëpitë e tyre dhe zakonet e traditat e tij. Por ajo që e tërhoqi me shumë vëmendjen e udhëtarëve e studiuesve të huaj ishte veshja konispolate. Veshja ose kostumet popullore të gruas e kultit konispolat shikohej me admirim nga kushdo si pasuri kulturore e popullit. Nga shënimet e studiuesve të shekullit XVIII-XIX janë përshkruar deri në hollësitë më të imta për variante e nënvariate për gra e burra dhe moshë të ndryshme. Bile ato dallohen në veshje të fshatrarëve të varfër dhe deri në veshje të shtresave të pasura, agallarëve e veshje luksi. Këto të dhëna përbëjnë burimin më me vlerë etnografik, historik e kulturor. Veshja e konispolatit, në këta dy shekuj e deri në gjysmën e parë të shekullit XX, mori tiparet e veshjes së kostumit kombëtar të krahinës, e

veçantë për burrat dhe për gratë. Pjesët përbërëse të veshjes së burrave janë:

1. Kapelja e bardhë me lesh deleje të hollë e të rrafur (e regjur)
2. Guna, kondoguna me lesh dhie të rrafur ( e regjur në distile)
3. Jelek, xhamadan me copa të shtrenjtë të qëndisur me fije ari
4. Xhamadan leshi të hollë, cepi i qëndisur me fije të

zakondëshme, tek qafat e duarve dhe gryka dhe tek vendet e kopsitjes, xhamadan i thjeshtë .

5. Këmishë e bardhë
6. Brezi
7. Shamia e mesit
8. Fustanella
9. Kalcat
10. Lidhësat e xhufkat
11. Papuçet (këpucët) me xhufka

Kostum tjetër burrash:

1. Këpucë me prroka
2. Pantallona (poture)
3. Këmishë
4. Xhamadan i thjeshtë
5. Kapelja

Pjesët përbërëse të veshjes së gruas janë:

1. Këpucë, nallane, sandale
2. Çarape të qëndisura tek sytë e këmbëve
3. Brez
4. Fust, fustan, përparëse
5. Këmishë prevezhane
6. Jelek
7. Posh



Kostum tjetër grash:

1. Këpuçë
2. Çorape
3. Dullama
4. Këmishë e zakonëshme ose prevezhane
5. Jelek
6. Sako
7. Posh
8. Të brendëshme(sytjana të qëndisura anash, mbathje të qëndisura anash)

Ja si e përshkruan bukurinë e këtyre kostumeve popullore Erkati: "Veshja për gra e stilit çam, e rregulluar prej artistëve të Janinës, për nga kompozicioni është gjëja më e përkryer në formën e kostumit, që unë kam parë ndonjëherë. Bukurinë kjo veshje s'ia ka borxh as perlave, as gurëve të çmuar, as shkëlqimit të dantellave të arta e të argjenda dhe as ngjyrave të shumta e plot kontrast. Veshja e brendëshme është prej mëndafshi ose mëndafshi i përzier me pambuk e me qenare tërë ngjyra me nuanca delikate. Veshja e jashtme që i jep kostumit bukurinë e tij karakteristike është një copë me ngjyrë të lehtë por jo të çelur si p.sh e verdhë në kafe, kafe në gur kali dhe e qëndisur bukur me gajtane, të vegjël të rumbullakët, zakonisht në të njëjtën ngjyrë por me një nuancë më të çelur, ose më të errët se ngjyra e cohës. Kjo veshje e jashtme nuk ka mëngë dhe shërben si koracë për trupin, veçanërisht reth belit mbrapa, duke u derdhur poshtë si kinda të bollshëm. Në shpinë dhe në bel, nga të dya anët, qëndisja është e hollë dhe e përsosur"

Nga sa u përshkrua më lart, disa nga admiruesit e veshjeve popullore e kanë vlerësuar kështu kostumin popullor të gruas çame "një prej kostumeve kombëtare më të bukura në Europë" Pikërisht këtë thënie e citon sociologu dhe etnografi Leake W. M. Travels...V.I faqe 45. Veshja e kostumit popullor të Konispolit del si pjesë përbërëse e kostumit kombëtar të Çamërisë, që ashtu si kostumet e trevave të tjera të Shqipërisë u

formuan plotësisht në shekujt XVIII-XIX.

Nga fotografitë që disponojmë nga ish banorët e Konispolit rezulton se veshja e burrave paraqitet mjaft qartë nga fotografia e patriotit të shquar nga Konispoli Alush Taka.



Alush Taka

Ajo është fotografi e fundit të shekullit XIX dhe përbën veshjen e kostumit popullor tradicional të burrave. Edhe në fillimet e shekullit të XX si dhe deri në ditët tona kostume të tilla mbaheshin në sepete dhe visheshin në ditë festash kombëtare, festivale etj. Valltarët e Konispolit janë përfaqësuar në festivalin kombëtar dhe kanë zënë vende të rëndësishme, duke përdorur për petk këto veshje popullore tradicionale.



Valltarët Taip Madani dhe Alush Doraci nga Konispoli duke hedhur vallen e Osman Takës



Grupi i Konispolit në një nga festivalet folklorike kombëtare

Por për përdorim të përditshëm janë përdorur veshje të thjeshta ose kostume fshatare më funksionale që në fillim të shekullit të XX . Siç duket kjo ishte një veshje e evoluar dhe e përdorimit të përditshëm edhe në fshatrat ose periferitë e Konispolit. Kësaj veshje e shtrojeve i kanë shërbier punimi i leshit të deles dhe të dhive nëpërmjet avëlmendeve ose argalive që kanë patur përdorim të gjerë në Konispol dhe në fshatrat reth tij.

Vallet elegante e plot kalorit me kostume popullore të Konispolit janë kërcyer në festivalet e Gjirokastrës, në ansamblet e Tiranës, në disa qytete të Greqisë, Italisë etj. ,me në krye laueratin Taip Madani, të shoqëruar nga Alush Doraci, Vullnet Dine, Shkëlqim Jahaj, Qazim Dine e Ramush Veliu, etj.Ndërsa vallja tradicionale “Me kadale vallen-o moj sy zezë” është kërcyer nga grupi elegant i grave e vajzave në festivalin e Gjirokastrës me Besnike Mullain, Valentina Eminin, Ferasete Avdulin, Violeta Veliun, Lindita Kasapin e Kadrie Murtajn.

Përveç kostumeve popullore pjesë përbërëse e kulturës popullore të Konispolit kanë qenë orënditë shtëpiake, qëndistaria ose puna e dorës tek gratë e vajzat, zejet e punimit të leshit, metalit, drurit, mënyrat e traditat e të ushqyerit etj.

Për këto aspekte mjafton të përmendim citimin e studiuesit anglez Hobhauz në shekullin XIX: “Orenditë e shtëpive nuk kanë shumë artikuj, por janë të mjaftueshme për të plotësuar nevojat e tyre. Një sini e madhe e rrumbullakët prej metali ku ata hanë dhe të cilën e mbajnë dritë të pastër, një tigan ku përzihet gjella, një ose dy kupa të drunjta dhe disa lugë prej druri, disa poçe për vaj dhe verë, një ibrik të vogël kafeje dhe një kandil (braus-laup), tre ose katër rrogozë të bardhë prej kallami, një fron(stol), një bllok (trung) të rrumbullakët prej druri rreth një këmbe e lartë ku vendoset sinia. Këto janë të gjitha artikujt që gjenden në shtëpitë e tyre, të cilat ruhen ose në një dollap të pastërt ose në një sunduk të drunjtë”.

Ndër zejet e punimit të leshit të deles dhe të drithrave më e

përhapur ka qenë avëlmendi ose siç quhet në gjuhën e popullit argalia. Me këtë punoheshin rrobat për veshje dhe për shtrojë. Një punim i veçantë dhe plot elegancë ka qenë prodhimi i veshjes së jashtme të bariut, guna dhe kondoguna. Këto prodhime, pasi punoheshin, i çonin në distilat e Dishatit (fshat aty pranë ku kishte në mesjetë shtatë distila në gjendje të mirë)

Në punimet e dorës së grave e vajzave të Konispolit vendin më të rëndësishëm e kanë zënë bandat e murit, zbukurueset e harqeve të dritareve e dyerve, zbukurimet e tavolinës së mezit të dhomës, zbukurimet në shamitë e dhomës. në këllëfet e jastëkut, në këmbët e tumanëve etj. Motivet kryesore që përdoren qenë, motive gjeometrike, spirale, shpendë, kafshë, dielli, hëna etj.



Kostume popullore të Konispolit

## TË HUAJT PËR KONISPOLIN

Aristoteli: "Mbi historinë e kafshëve". . . "Kafshët e mëdha kanë nevojë për shumë ushqim, por kjo krahinë ka shumë kullota të mira dhe vende të përshtatëshme për çdo stinë".

Halil Inalcik: "Sureti defteri Sançak arvonind 1431-1432". . . "Konispoli, fshat me një skelë (skela e Shën Todhorit, shënim i H. Shabanit) me 1200 akce, live (gra të veja) 2, Have 21, Beqar 3, dhe të ardhura të përgjithshme me shumën prej 2667 akce".

M. Urban: "Studime mbi Shqipërinë e jugut"  
"Çamët që në antikitet ishin dhënë më shumë pas punës, pas tregëtisë, pas bujqësisë, se sa pas luftës. . . Çamëria është krahina që ka pasur më shumë qytete se krahinat e tjera. Konispoli, Sajadha, Filati, Margëlleçi, Paramithia, Ajdonati, Parga, Arta dhe Preveza lulëzojnë gjer në ditët tona."

"Udhëtim në Greqinë veriore e në Shqipëri"

Pukevili: (Konsulli francez në Janinë) "Me krijimin e pashallëkut të Janinës agallarët e Konispolit kërkonin pavarësi dhe për një perjudhë të gjatë kohe nuk iu bindën Ali Pashë Tepelenës. Përkundrazi u lidhën me Suljotët e Ibrahim Pashën e Beratit për të mos lejuar nënshtrimin e Çamërisë. . . . Më 1787 Ibrahim Pasha i Beratit dhe agallarët e Thesprotisë i kishin hedhur Suliotët kundër Ali Pashë Tepelenës. Çamërit kundërshtuan synimet e Aliut për të nënshtruar Artën e Çamërisë. . . . Bejlerët e agallarët

e Çamërisë me Suliotët formuan një beslidhje kundër Aliut e cila përbëhej prej Vezir Ibrahim Beratit, Mustafa Pashë Delvinës, Islam Pronjos nga Paramithja, Dajlanëve të Konispolit dhe bejlerëve të Çamërisë, të cilët u kishin paguar një ndihmë prej 40 qesesh luftëtarëve të Sullit”

Martin Lik:“Udhëtim në Greqinë veriore”. . . .”25 dhjtor 1804. Reth 20 ditë më parë pati një betejë në Konispol ndërmjet dy partive në të cilat ishte qyteti, në krye të njëres është Mahmud Dalani . . . . .Kryetari tjetër është Ismail Agai, një mik i Vezirit, ndihmën e të cilit ai kërkoi. Partia e Vezirit në Konispol e Filat quhet Jakobine prej kundështarëve të tyre në imitim të emërtimeve të partive korfjate”

A.Psalidha-Kozma Thesprotu: “Ajo, Çamëria ,ujitet nga tre lumenj, Akerondi, Thyanis e Dodoni(lumi i Sullit, Kalamai e Bistrica). Ka tre qytete, Delvina, Paramithia e Praga. Fshatra ose qyteza të rëndësishme janë: Filati, Margëllec, Kuçi, Konispoli(të banuar nga muslimanët), Grykëhori, Karabunara, Grava, Plashavica, Finiqi, Jeromeri e Sajadha(të banuar nga të krishterë grekë) etj. Në Çamëri bën pjesë dhe Suli.

Epiri eksporton kripë, grurë për arme, tabako, hudhra, ngjala, vezë, peshk, lesh delesh e lëkurë lepujsh. Epiri ka shumë manastire, 85 të tillë. Ka kështjella të vjetra e manastire. Në Konispol ka manastir(bëhet fjalë për Manastirin e Shën Kollit në Çiflik i cili ka qenë në varësi të qendrës ortodokse të Vagalatit, shënim i H. Shabanit).

Straboni: . . . . .”Toka është e begatë sepse lumenjtë: Bisticë, Kalasë, Pavel, Kalama e lumi Oliqisë ujin shumë tokë. Prodhoen edhe duhan shumë i mirë, dru arre, mjaltë shumë i mirë”

Araventinoi: “Hornografi e Epirit”. . . Prodhimet e Epirit në 1840 ishin këto: drithra, fasule, qiqra, qe, lopë, dhen, kuaj, mushka, farë lini, lesh, lëkurë delesh e lepujsh, duhan, tabako, peshk, havajar, oriz, djathë, gjalpë, pula, ullinj, vaj, dru për industri e djegje, mëndafsh, dyllë, mjaltë, kripë, arme të ndryshme, lopata, flakota, velenxa, kostume shqiptare të thjeshta e të qëndisura, gajtanë ari, guna, lëkura të vogla të punuara e të bojatisura, katran, pijavicë etj. Këto dilnin nga Narta, Çamëria, Vlora, Janina,

Gjirokastra, Delvina, Preveza, Parga, Konica e Konispoli. . . . .Shitja bëhej në ishujt e Jonit Trieste, Maltë, Greqi, Livorno, Londër, Tunis, Stamboll, Napoli, etj.

Hjuzi-Hollandi: “Liku fshatin Vagalat dy-tri milje në lindje të Butrintit e quan “qytet të vogël” kurse Kardhiqin “qytet të madh” po ashtu dhe Konispolin”

Erkharti: “Veshja për gra e stilit çam ose e Shqipërisë së jugut e rregulluar prej artistëve të Janinës, për nga kompozicioni është gjëja më e përkryer në formën e kostumit që unë kam parë ndonjëherë. Bukurinë kjo veshje s’ia ka borxh, as peshave të gurëve të çmuar, as shkëlqimit të tantellave të arta e të argjenta, dhe as ngjyrave të shumta e plot kontraste”

Spenseri: “Gramatika dhe fjalori i Ksilandrit atij i hyri në punë kur vizitoi Çamërinë, por jo aq sa duhej, “edhe midis mirditorëve dhe toskëve” aq më tepër që këta të fundit e flasin gjuhën në tërë pastërtinë e saj”

Hjuz: “Ne u kënaqëm shumë më tepër me dëfrimin që pasoi, ekzekutivi i Albaniticos ose i valles kombëtare të palikarëve shqiptarë, e luajtur nga disa prej rojeve më të zotë të Vezirit, që ishin ftuar në dasmën. . . .Ata i printe korifeu ose udhëheqësi i cili, ndërrohej shpesh, ai bënte kërcime mahnitëse, duke u përkulur nga mbrapa, deri sa koka e tij gati sa s’prekte dyshemenë, dhe pastaj me një kërcim elastik të shigjetës së një harku, fluturonte lart, ndërsa flokët e gjatë i valëviteshin të shpupuritura mbi sup”

Përshkrime të përafërta japin edhe Hobhausi, Hollandi, Liku, Lejardi etj. Me siguri që bëhet fjalë për vallen tradicionale të “Osman Takës”(shënim i H. Shabanit)

“Dielli Dosja Nr. 14 V, 1830-1912(M.H.Shbani)”

“Të tillë ishin komiteti i fshehtë i Delvinës, klubet shqiptare në Delvinë, Konispol, Ninat, Janjar e Filat në vitet 1908-1911 si dhe shoqëria “Vllaznia” e Konispolit që u krijua në 1920 e që zhvilloi aktivitetet për disa vjet”.

Qendra e kësaj shoqërie ishte në Konispol, kryesia e shoqërisë



“Vllaznia” u përpoq të lidhej edhe me shqiptarët që gjendeshin jashtë shtetit e veçanërisht me ata të Amerikës. Kjo shoqëri zhvilloi një aktivitet të mirë kulturor dhe arsimor duke çelur shkolla shqipe në fshatrat rreth Konispolit.

Sami Frashri (1895) “Populli që quhet Çam janë trima e të zgjut dhe kanë pamje personash të mirë dhe janë me za për bukuri. Kërcimet i kanë të kandëshme e të hijshme”

## PËRMBLEDHJE

Monumentet e këtij libri modest plotësojnë një pjesë fare të vogël të pasurisë së madhe kulturore që ka trashëguar populli shqiptar i krahinës së Konispol-Markatit, nga e kaluara e tij. Megjithatë kjo trashgimi kulturore i fillon dëshmitë e saj arkitektonike që nga prehistoria, antikiteti mesjetar e deri në ditët tona. Treguesit e artit në shpellën prehistorike të Kreshmoit të Konispolit 26.000 vjet më parë me objektet prej qeramike e prej stralli e kocke e rendit Konispolin ndër vendbanimet më të hershme të trevave iliro-epirote.

Qendra e rëndësishme e qytetit antik të Çukës së Ajtoit me shëmbullin klasik të portës me qemer, "pallatin", banesat me gurë etj përbëjnë një pasuri me vlera të larta në arsenalin arkitektonik iliro-epirot për shekujt V-IV para Krishtit. Godina shoqërore e pallatit të qytetit të Çukës së Ajtoit, është një nga ndërtesat më të goditura nga pikpamja arkitektonike. Sigurisht që brenda kësaj vlere qëndrojnë edhe muret rrethuese poligonale dhe portat tagenciale e të tipit të Trojës ndërtuar në qytetin antik të Çukës së Ajtoit, fare pranë Konispolit. Gjatë antikitetit të vonë e sidomos gjatë shekullit V-IX kemi një aktivitet të mirë arkitektural në vendbanimin e Bregut të Sterrës, (në këmbët e qytetit të Konispolit) që dëshmon për një nivel të lart kulturor dhe ekonomiko-shoqëror të trevës së Epirit në këtë periudhë. Elementi i përfaqësuar në disa banesa të Bregut të Sterrës si ai i sofatit prej guri ose i "pezullit" siç flitet në gjuhën popullore është element i ardhur që nga dimini, mbase i trashëguar edhe nga qyteti antik i Çukës së Ajtoit.

Me siguri që në këtë vendbanim tipik të antikitetit të vonë, të Bregut të Sterrës është trasmentuar qemeri ose harku në banesat e ndërtuara, por gjendja e tyre është gjysëm e rrënuar, nuk e ka sjellë deri në ditët tona qemerin e banesave.

Shekulli XV dhe pas tij është i mbushur me luftrat Shqiptaro-Turke dhe me vendosjen e regjimit feudalo-ushtarak. Vendin e qyteteve të lira dhe të ndërtimeve publike e zenë qendrat ushtarake administrative. Qendrat qytetare u shndruan ose u reduktuan në qendra të vogla që kryenin funksionet e tregjeve lokale. E vetmja veprimtari ndërtimore me rëndësi në këtë periudhë që në lidhje me ndërtimin e faltoreve islamike. Në Konispol u ndërtuan pesë xhami, një medrese, disa banesa të ushtrisë turke, (koshadhet) dhe disa tyrbe. Ndërsa ndërtimet inxhinjerie si ura etj në Konispol mungojnë pasi nuk përshkohet nga ndonjë lumë. Por krahas këtyre, në shekujt XVII e deri në fillimet e atij XX, një vend të rëndësishëm në Konispol zunë, pasuria më e madhe në fushën e arkitekturës, banesa qytetare.

Në vendin tonë, sipas vlerës, shumë a qytete janë cilësuar si qytete muze si Berati e Gjirokastra, në disa qytete të tjera janë vënë në mbrojtje lagje të vjetra me cilësinë e qendrave historike. Në këtë këndvështrim ia vlen të lagja e Shehaitit të Konispolit që ka një ansambël banesash me arkitekturë të zhvilluar të mbrojtur. Banesa qytetare e Konispolit ka përshkruar një revolucion të gjatë, i cili i ishte përgjigjur zhvillimit ekonomik e shoqëror të vendit, strukturës klasore e të shoqërisë qytetare.

Nga fundi i shekullit XVIII formohen plotësisht disa tipe të zhvilluara banesash qytetare, si dhe banesa të fortifikuara gjirokastrite dhe banesa me Çardhak (një ekzemplar ka arritur të ruhet deri në ditët tona). Këto tipe banesash ishin të lidhura me formacionin feudal të shoqërisë. Reth mezit të shekullit XIX banesa qytetare mori një drejtim të ri, duke marrë gjithçka pozitive nga tradita e pasur. Vlerat e këtyre banesave të Konispolit rriten atëherë kur krahas tyre do të shtohen edhe banesat qytetare të fshatrave Vërvë, Shalës e Markat, që i takojnë periferisë së Konispolit.

Pa dyshim që arti tradicional i trashëguar kryesisht nga punimet prej qeramike nga shpella e Kreshmoit të Konispolit përbën vlerat më të larta të tij. Larmia e punimeve të "bukuroshja e Konispolit" në disa variante, "valltaret" në terrakota prej balte, dekoracionet gjeometrike e spirallike, paraqitja e shtatoreve të femrës, format skematike të njeriut, etj janë një pasuri e rrallë dhe e vetme e këtij lloji në vendin tonë. Punimet prej druri kanë arritur më pak deri në ditët tona, megjithatë imazhin e zvillimit të tij e japin disa tavane dekorative zbukuruar me forma gjeometrike, rozeta shqiponja etj.

Shumë pozitive është fakti që sot në Konispol e ka ngritur artin në një shkallë cilësore piktori skulptori i talentuar Urim Arapi. Ai ka mundur të trasmentojë traditën e artit të lashtë të Konispolit në gur, dhe ta aplikojë atë në praktikë. Kështu përveç skulpturave të spikatura ai ka ndërtuar oxhaqe dekorative, shatërvane prej guri, rozeta e tavolina prej guri me tregues cilësor dhe të lakmuar brënda e jashtë vendit.

